



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.148

8 nëntor

2010

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.794, datë 6.10.2010	Për licencimin e shkollës së lartë private “Tirana Business University”, Tiranë	7921
Vendim i KM nr.795, datë 6.10.2010	Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e dytë të studimeve, “Master profesional”, për vitin akademik 2010 – 2011.....	7922
Vendim i KM nr.796, datë 8.9.2010	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.787, datë 14.12.2005 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”, të ndryshuar	7928
Vendim i KM nr.799, datë 29.9.2010	Për një shtesë në vendimin nr.549, datë 26.8.1996 të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e tarifave të shërbimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar	7929
Vendim i KM nr.800, datë 29.9.2010	Për një ndryshim në vendimin nr.730, datë 7.11.2007 të Këshillit të Ministrave “Për dhënien në përdorim Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Ministrisë së Integritit, Avokatit të Prokurimeve Publike, Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe Agjencisë së Prokurimit Publik të disa mjediseve të ndërtesës (godinës) së ish-INIMA-s”, të ndryshuar	7929
Vendim i KM nr.801, datë 29.9.2010	Për shfuqizimin e vendimit nr.513, datë 21.9.2000 të Këshillit të Ministrave “Për detyrimin e mjekëve që duan të specializohen”	7933

Vendim i KM nr.802, datë 29.9.2010	Për rishpërndarje fondesh buxhetore, për shpenzime korente, ndërmjet programeve, brenda buxhetit të vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	7933
Vendim i KM nr.803, datë 6.10.2010	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2010, miratuar për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, për rritjen e pagave të punonjësve	7934
Vendim i KM nr.804, datë 6.10.2010	Për dhënie fondi shtesë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për financimin e zgjedhjeve të pjeshme për kryetar komune, në komunën Trebinjë, qarku Korçë, më 24 tetor 2010	7934
Vendim i KM nr.805, datë 6.10.2010	Për disa shtesa në vendimin nr.591, datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore”, të ndryshuar	7935
Vendim i KM nr.806, datë 6.10.2010	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Petran, të qarkut të Gjirokastrës	7936
Vendim i KM nr.807, datë 6.10.2010	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Levan – Tepelenë	7937
Vendim i KM nr.809, datë 6.10.2010	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Zerqan, të qarkut të Dibrës	7953
Vendim i KM nr.810, datë 6.10.2010	Për rishpërndarje fondesh, ndërmjet programeve, në buxhetin e vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës	7954
Vendim i KM nr.811, datë 6.10.2010	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, për ndërtimin e një kampusi të ri universitar, të pronës, tokë bujqësore, të ndodhur në fshatin Akërnj, komuna Novoselë, në qarkun e Vlorës, aktualisht në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si fond për kompensimin fizik, dhe për një ndryshim në vendimin nr.868, datë 18.6.2008 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e fondit të kompensimit fizik nga fondi i tokës bujqësore”	7954
Vendim i KM nr.812, datë 6.10.2010	Për disa ndryshime në vendimin nr.463, datë 5.7.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit”, të ndryshuar	7955
Udhëzim i MB dhe MPPT nr.5688/1, datë 12.10.2010	Për zbatimin e masave të përbashkëta në disiplinimin e shërbimit taksi të transportit të udhëtarëve	7956

VENDIM
Nr.794, datë 6.10.2010

PËR LICENCIMIN E SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE “TIRANA BUSINESS UNIVERSITY”, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 4, 43, 44, 44/1 dhe 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Licencimin e shkollës së lartë private “Tirana Business University”, e cila ushtron veprimtarinë në qytetin e Tiranës.

2. Shkolla e lartë private “Tirana Business University”, Tiranë organizohet në dy fakultete:

a) Fakulteti i Administrim - Biznesit, që ofron programin e studimit të ciklit të parë, në fund të të cilit lëshohet diplomë “Bachelor”, në “Administrim – biznesi”, në tri profile:

i) Menaxhim,

ii) Marketing,

iii) Kontabilitet - financë.

b) Fakulteti i të Drejtës së Biznesit, në fund të të cilit lëshohet diplomë “Bachelor” në “E drejta e biznesit”.

3. Shkolla e lartë private “Tirana Business University”, Tiranë fillon veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

4. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

5. Shkolla e lartë private “Tirana Business University”, Tiranë duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe shkolla e lartë private “Tirana Business University”, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.795, datë 6.10.2010

**PËR KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT NË INSTITUCIONET
PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE “MASTER
PROFESIONAL”, PËR VITIN AKADEMIK 2010 - 2011**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 34, 35, 36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, të ligjit nr.10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës” dhe të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, për programet e studimeve të ciklit të dytë, për vitin 2010-2011, të jenë 6480. Këto kuota të ndahen, si më poshtë vijon:

- | | |
|---|-------|
| a) Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master profesional” | 6190; |
| b) Kuotat për programe të dyta studimi | 100; |
| c) Kuotat për transferimin e studimeve | 100; |
| ç) Kuotat për të huajt | 50; |
| d) Kuotat për të verbrit | 20; |
| dh) Kuotat për romët/ballkano-egjiptianët | 20. |

2. Kuotat e pranimeve të reja, për programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional”, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të këtij vendimi, përbëhen nga:

- | | |
|---|-------|
| a) Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master profesional”, për kandidatët brenda territorit të vendit | 5571; |
| b) Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master profesional”, për kandidatët shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit | 619. |

3. Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master profesional”, në përputhje me përcaktimet e shkronjës “a” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahen sipas programeve të studimit dhe institucioneve publike të arsimit të lartë, paraqitur në tabelën nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të dytë, sipas shkronjës “b” të pikës 2 të këtij vendimi, ndahen ndërmjet kandidatëve shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit: Republika e Kosovës, Maqedoni, Mali i Zi, Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë. Administrimi i këtyre kuotave kryhet në bazë të marrëveshjeve dypalëshe ndërmjet vendeve dhe akteve të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Shqipërisë. Këto kuota pranimi, të ndara sipas programeve të studimit dhe institucioneve publike të arsimit të lartë, për çdo program studimi, janë në masën 10% të kuotës përkatëse, paraqitur në tabelën nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Kuotat e pranimeve për të verbrit ndahen për kandidatët me statusin e të verbrit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të listës së hartuar nga Shoqata Kombëtare e të Verbërve.

6. Kuotat e pranimeve për romët dhe ballkano-egjiptianët ndahen nga MASH-i, në bazë të listës së hartuar të shoqatave respektive, Shoqatës Kombëtare të Romëve dhe Shoqatës Kombëtare të Ballkano-Egjiptianëve.

7. Kuotat e pranimi për shtetasit e huaj, që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, në ciklin e dytë të studimeve, sipas shkronjës “d” të pikës 1 të këtij vendimi, administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Ato të shpërndahen në bazë të marrëveshjeve dy apo shumëpalëshe ndërmjet vendeve.

8. Kuotat e pranimeve për një program të dytë studimi dhe transferimi i studimeve të përcaktuara në shkronjat “b” dhe “c” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, bazuar edhe në kërkesat e institucioneve publike të arsimit të lartë.

9. Çdo program studimi i ciklit të dytë funksionon në vitin e parë, për vitin akademik 2010-2011, në rast se atë e ndjekin të paktën 10 studentë.

10. Institucionet publike të arsimit të lartë përcaktojnë kriteret e pranimi të kandidatëve dhe i bëjnë ato publike paraprakisht.

11. Tarifat vjetore të shkollimit për studentët, që do të regjistrohen në vitin e parë, për të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional”, në vitin akademik 2010-2011, si dhe tarifat vjetore të shkollimit për studentët, që ndjekin një program të dytë studimi, janë sipas tabelës nr.2, bashkëlidhur këtij vendimi.

12. Kandidatët, që do të fitojnë të drejtën në një program studimi të ciklit të dytë në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2010-2011, dhe që u përkasin shtresave sociale, si: të verbër/të shurdhër, invalidë, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, fëmijë romë, ballkano-egjiptianë, jetimët apo fëmijë të policëve dhe ushtarakëve, të rënë për shkak të detyrës e të ish - të përndjekurve politikë, paguajnë një kuotë në masën 50% të tarifës së shkollimit. Këtë të drejtë do ta kenë edhe studentët e viteve më të larta, që u përkasin po këtyre shtresave sociale.

13. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife shkollimi, pagesa e së cilës bëhet me këste të përcaktuara nga institucioni i arsimit të lartë. Studentët përsëritës i nënshtrohen tarifës së shkollimit të vitit akademik, në të cilin vazhdojnë rregullisht studimet.

14. Në çdo program studimi, të ciklit të dytë të studimeve “Master profesional”, në vitin akademik 2010-2011, studentët e vitit të parë, që kanë përfunduar me medalje të artë ciklin e parë të studimeve, dhe studentët e vitit të dytë që kanë përfunduar shkëlqyeshëm vitin e parë, nuk e paguajnë tarifën e shkollimit në vitin akademik 2010-2011.

15. Shtetasit e huaj, që do të vazhdojnë studimet e ciklit të dytë në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen së njëjtës tarifë shkollimi, si shtetasit shqiptarë, me përjashtim të rasteve kur, me marrëveshje ndërshtetërore, është parashikuar ndryshe.

16. Transferimet e studimeve, në numrin përkatës të kuotës së përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas shkronjës “c” të pikës 1 të këtij vendimi, bëhet nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë, në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet nënligjore, në statutin dhe rregulloret e tyre.

17. Studentët, që transferojnë studimet nga një program studimi apo nga programe të mëparshme studimi të ciklit të dytë në një program tjetër studimi në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen tarifës së përgjithshme vjetore të shkollimit të programit të studimit përkatës, në të cilin ata kanë kërkuar të transferojnë studimet.

18. Rishpërndarja e kuotave të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të cilat mbeten të përcaktuara, bëhet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bashkëpunim me institucionet publike të arsimit të lartë.

19. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tabela nr.1

TABELA E KUOTAVE " MASTER PROFESIONAL "

Nr	Emërtimet e programeve të studimit	UT	UPT	UBT	UE	USH	UK	UGJ	UV	UD	UST	Shuma
		2010-2011	2010-2011	2010-2011	2010-2011	2010-2011	2010-2011	2010-2011	2010-2011	2010-2011	2010-2011	
1	Mësuesi në CLAB në Gjuhë - Letërsi				60	100	70	70				300
2	Mësuesi në CLAB në Biologji - Kimi				80	100		60				240
3	Mësuesi në CLAB në Gjuhë Italiane				35	60		40				135
4	Mësuesi në CLAB në Gjuhë Gjermane				25	60						85
5	Mësuesi në CLAB në Gjuhë Frënge				30	60						90
6	Mësuesi në CLAB në Gjuhë Angleze				40	100	50	60				250
7	Mësuesi në CLAB në Matematikë – Fizikë				70	60	20	60				210
8	Mësuesi në CLAB në Matematikë – Informatikë				30	60		60	80			230
9	Mësuesi në CLAB në Histori – Gjeografi				60	100		70				230
10	Mësuesi në CLAB në lëndën Edukim Fizik e Sporte					60						60
11	Mësuesi në CLAB në Gjuhën Greke për lëndët shoq							25				25
12	Përkth dhe Adm i Vlerave të Kulturës Tradicion							25				25
13	Mësuesi në AM në Shkenca Sociale	50					50					100
14	Mësuesi në AM në Gjuhë Angleze	150				30			80			260
15	Mësuesi në AM në Gjuhë Frënge	60				30						90
16	Mësuesi në AM në Gjuhë Gjermane	60				30						90
17	Mësuesi në AM në Gjuhë Italiane	80				30			80			190
18	Mësuesi në AM në Gjuhë-Letërsi	120				30	40					190
19	Mësuesi në AM në Histori	150				30						180
20	Mësuesi në AM në Gjeografi	120				30						150
21	Mësuesi në AM në Kimi	50				30						80
22	Mësuesi në AM në Biologji	60				30						90
23	Mësuesi në AM në Fizikë	50										50
24	Mësuesi në AM në Matematikë- Fizikë					30			80			110
25	Mësuesi në AM në Matematikë	80							80			160
26	Trainingu sportiv											0
27	Mesues per AM fiskulture					30					75	105
28	Stërvitje Sportive										50	50

29	Mësuesi në AM në Informatikë							80			80
30	Menaxhim infermieror	180									180
31	Teknin laborator	40									40
32	Mami	40									40
33	Fizioterapi	40									40
34	Imazheri	50									50
35	Teknologji Informati	40									40
36	Zhvillim i integruar rural						40				40
37	Operacione industriale dhe navale										0
38	Edukatë qytetare dhe gjeografi				60						60
39	Edukatë qytetare dhe histori				70						70
40	Redaktim	60			30						90
41	Drejtim dhe administrim arsimit	50									50
42	Qeverisje dhe politikë publike	60									60
43	Këshillim psikologjik	40									40
44	Orientim profesional	50									50
45	Punë sociale	80									80
46	Filozofi praktike dhe humane	30									30
47	Analizë e politikës sociale	60									60
48	Teknologji e avancuar në hortikulturë				30						30
49	Mbrojtja kimike dhe fitofarmacia				25						25
50	Biznes blegtoral				25						25
51	Teknologji e kultivimit të bimëve				40						40
52	Menaxhim mjedisi				40						40
53	Menaxhim i ndërmarrjeve										0
54	Ekonomi dhe agrobiznes										0
55	Ekonomi dhe politikë agrare										0
56	Redaktori										0
57	Gjuhësi				20						20
58	Gjeomorfologji										0
59	Arkivistikë	30									30
60	Sipërmarrje dhe Turizëm							80			80

61	Kontabilitet Financë							90				90
62	Administrim Publik							70	80	50		200
63	Menaxhim Biznesi									50		50
64	Menaxhim Administrim Financiar									50		50
65	Marketing									50		50
66	Turizëm							60		50		110
67	Finance Banke									50		50
68	Menaxhim I SME									50		50
69	Përkthim dhe Interpretim në Gjuhë Gjermane											0
70	Inxhinieri Mekanike		30									30
71	Inxhinieri Tekstile dhe Mode		25									25
72	Infermieristikë									80		80
73	Studime të Avancuara Detare									80		80
74	Punonjës social me fëmijët dhe familjen				80							80
75	Psikolog në Institucione				80							80
	Shuma	1880	55	160	770	1090	270	690	800	350	125	6190

Tabela nr.2

Tarifat e shkollimit për programet e studimit “Master profesional” me kohë të plotë, në të gjitha institucionet publike të arsimit të lartë në vitin akademik 2010-2011:

a) Për programet e studimit “Master profesional”, në mësuesi për ciklin e lartë të arsimit bazë, të jetë:

i) Për lëndët fizikë, matematikë, informatikë apo kombinimet e tyre 31 500 lekë;
 ii) Të gjitha programet e tjera 42 000 lekë.

b) Për programet e studimit “Master profesional”, në mësuesi për arsimin e mesëm, të jetë:

i) Për lëndët fizikë, matematikë, informatikë apo kombinimet e tyre 42 000 lekë;
 ii) Të gjitha programet e tjera 47 250 lekë;

c) Për të gjitha programet e tjera “Master profesional” 63 000 lekë.

Tarifa e shkollimit për programet e dyta të studimit

“Master profesional” me kohë të plotë, në të gjitha institucionet publike të arsimit të lartë në vitin akademik 2010-2011:

a) Për programet e studimit “Master profesional” në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, të jetë:

i) Për lëndën fizikë, matematikë, informatikë apo kombinimet e tyre 63 000 lekë;
 ii) Të gjitha programet e tjera 84 000 lekë.

b) Për programet e studimit “Master profesional”, në mësuesi për arsimin e mesëm, të jetë:

i) Për lëndën fizikë, matematikë, informatikë apo kombinimet e tyre 84 000 lekë;
 ii) Të gjitha programet e tjera 105 000 lekë.

c) Për programet e tjera “Master profesional”

i) Në Fakultetin e Infermierisë 210 000 lekë;
 ii) Të gjitha programet e tjera 105 000 lekë.

VENDIM
Nr.796, datë 8.9.2010

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.787, DATË 14.12.2005 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË
PROCEDURAVE DHE TË MASËS SË NDIHMËS EKONOMIKE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10, 19, pika 3, 20, pika 2, 29, pika 10, e 35, të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.787, datë 14.12.2005 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas shkronjës “ç” të pikës 1, shtohet shkronja “d”, me këtë përmbajtje:

“d) Viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesit shoqëror deri në çastin e punësimit të tyre.”.

2. Pas pikës 7 shtohet pika 7/1, me këtë përmbajtje:

“7/1.Viktima e trafikimit paraqet dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kopjen e noterizuar të letërnjoftimit;

b) Vërtetimin si punëkërkues i papunë, të lëshuar nga zyra përkatëse e punësimit;

c) Vërtetimin e daljes nga institucionet e përkujdesit shoqëror për viktimat e trafikimit.”.

3. Në pikën 14, pas fjalëve “... apo anëtarëve të saj...” shtohen “...dhe kategorive përfituese sipas pikës 1 të vendimit...”.

4. Pas pikës 18 shtohet pika 18/1, me këtë përmbajtje:

“18.1 Masa e ndihmës ekonomike për viktimat e trafikimit është 3000 (tre mijë) lekë në muaj. Kjo ndihmë ekonomike përfitohet pas daljes nga institucionet e përkujdesit shoqëror, deri në çastin e punësimit të tyre.”.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 tetor 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.799, datë 29.9.2010

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.549, DATË 26.8.1996 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR CAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË ZYRAVE TË
REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 54 e 56 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 1 të vendimit nr.549, datë 26.8.1996 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“1/1. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe njësitë e qeverisjes vendore përjashtohen nga tarifat e shërbimeve, për të gjitha veprimet që do të kryejnë pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme për pasuritë e paluajtshme publike, pyje dhe kullota që kanë në pronësi/përdorim.”.

2. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.800, datë 29.9.2010

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.730, DATË 7.11.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR DHËNIEN NË PËRDORIM AGJENCISË KOMBËTARE TË
SHOQËRISË SË INFORMACIONIT, MINISTRISË SË INTEGRIMIT, AVOKATIT TË
PROKURIMEVE PUBLIKE, QENDRËS KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT DHE
AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK TË DISA MJEDISEVE TË NDËRTESESË
(GODINËS) SË ISH-INIMAS”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:


1. Në vendimin nr.730, datë 7.11.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtojca nr.1, që i bashkëlidhet vendimit, zëvendësohet me shtojcën me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Integrimit, Avokati i Prokurimeve Publike, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Qendra Kombëtare e Regjistrimit dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

7929




PLANIMETRIA e katit NENTOKE



Shtojca 1 / 3

Planimetria e Katit te Pare



VENDIM
Nr.801, datë 29.9.2010

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.513, DATË 21.9.2000 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR DETYRIMIN E MJEKËVE QË DUAN TË SPECIALIZOHEN”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shfuqizimin e vendimit nr.513, datë 21.9.2000 të Këshillit të Ministrave “Për detyrimin e mjekëve që duan të specializohen”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.802, datë 29.9.2010

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH BUXHETORE, PËR SHPENZIME KORENTE,
NDËRMJET PROGRAMEVE, BRENDA BUXHETIT TË VITIT 2010, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TË BARABARTA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 16 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve, për shpenzime korente, ndërmjet programeve brenda buxhetit të vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, si më poshtë vijon:

a) Programit të planifikimit, menaxhimit dhe administrimit t’i shtohet fondi prej 5 000 000 (pesë milionë) lekësh.

b) Programit të mbrojtjes sociale t’i pakësohet fondi prej 5 000 000 (pesë milionë) lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.803, datë 6.10.2010

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR DREJTORINË
E SHËRBIMEVE QEVERITARE, PËR RRIJTJEN E PAGAVE TË PUNONJËSVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, në buxhetin e miratuar për vitin 2010, t’i shtohet fondi prej 2 857 726 (dy milionë e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e njëzet e gjashtë) lekësh, për rritjen e pagave të punonjësve të këtij institucioni.
 2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.
 3. Ngarkohen Kryeministria, Ministra e Financave dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.804, datë 6.10.2010

**PËR DHËNIE FONDI SHITESË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PËR
FINANCIMIN E ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR KRYETAR KOMUNE, NË
KOMUNËN TREBINJË, QARKU KORÇË, MË 24 TETOR 2010**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për financimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar komune, në komunën Trebinjë, qarku Korçë, më 24 tetor 2010, t’i jepet një fond shtesë prej 1 542 000 (një milion e pesëqind e dyzet e dy mijë) lekësh, të ndarë përkatësisht:
 - 542 000 (pesëqind e dyzet e dy mijë) lekë për paga e sigurime;
 - 1 000 000 (një milion) lekë për materiale e shërbime.
 2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.
 3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.805, datë 6.10.2010

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.591, DATË 23.7.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR DISIPLINIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE BUXHETORE”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të shkronjës “ç” të pikës 3 të kreut I të vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të shkronjës “dh” të pikës 1 të vendimit nr.591, datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohen paragrafët, me këtë përmbajtje:

“Përfundimisht, lejohet Ministria e Shëndetësisë, Drejtoria e Shëndetit Publik, Korçë, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit për objektin “Rikonstruksion dhe shtesë kati për ndërtesën e klinikës dentare”.

Përfundimisht, lejohet Ministria e Shëndetësisë, Drejtoria e Spitalit, Korçë, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit për objektin “Ndërtimi i sistemit të ngrohjes dhe ujit sanitar për spitalin e Korçës”.

Përfundimisht, lejohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe instituconet e saj të varësisë, si autoritete kontraktore, të vijojnë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit dhe lidhjen e kontratave për projektet dhe shërbimet, si më poshtë vijon:

i) Për blerjen e pajisjeve elektronike të laboratorëve të informatikës për arsimin e mesëm profesional, me fondet e miratuara me vendimin nr.748, datë 15.9.2010 të Këshillit të Ministrave.

ii) Për blerjen e librave artistikë për krijimin e fondit të bibliotekave për vitin shkollor 2010, në të gjitha drejtoritë rajonale arsimore dhe zyrat arsimore në rrethe.

iii) Për blerjen e mallrave, shërbimeve, rikonstruksioneve dhe ndërtimit të objekteve në institucionet e arsimit të lartë, të cilat kanë si burim financimi fonde nga të ardhurat dytësore apo donatorët.

iv) Për blerjen e mallrave, shërbimeve, rikonstruksioneve dhe ndërtimit të objekteve në institucionet e sistemit të arsimit dhe njësitë e pushtetit vendor, të cilat kanë si burim financimi, fonde në kuadër të projektit “Cilësi dhe barazi në arsim.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.806, datë 6.10.2010

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS PETRAN, TË QARKUT TË GJIROKASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Petran, të qarkut të Gjirokastrës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Petran të qarkut të Gjirokastrës, miratuar me vendimin nr.104, datë 3.2.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Petran, të qarkut të Gjirokastrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Petran për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Petran

Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën administrative.	Në pronësi
3-20	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
21-27	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore.	Në pronësi
31-45	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik.	Në pronësi
46-58	Varrezat publike	Në pronësi
63-79	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
80,81,83-86,88-89,91-94, 96-98,100-102,104-105,107-110,112-114,116-118,120-122,124-125,127-130,132,134-137,139-142	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
82,87,90,95,99,103,106,111,115, 119,123,126,131,133,138,143,151, 152,165,168,176,177,184,185,195, 196 (vetëm kanalet e treta)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproductive dhe kanale të treta).	Në pronësi
1020-1028	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile.	Në pronësi

1031-1033	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
1034-1055	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi

VENDIM
Nr.807, datë 6.10.2010

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR LEVAN - TEPELENË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për buxhetin e shtetit për vitin 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Levan - Tepelenë.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelat bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 81 393 m², tokë arë, me vlerë 34 391 180 (tridhjetë e katër milionë e treqind e nëntëdhjetë e një mijë e njëqind e tetëdhjetë) lekë; sipërfaqen 5177 m², tokë truall, me vlerë 3 090 898 (tre milionë e nëntëdhjetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë; sipërfaqen 22 656 m², kullotë, me vlerë 2 569 531 (dy milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e tridhjetë e një) lekë; sipërfaqen 1450 m², pyje, me vlerë 221 850 (dyqind e njëzet e një mijë e tetëqind e pesëdhjetë) lekë; objekte, me vlerë 23 247 700.52 (njëzet e tre milionë e dyqind e dyzet e shtatë mijë e shtatëqind pikë pesëdhjetë e dy) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 63 521 159.52 (gjashtëdhjetë e tre milionë e pesëqind e njëzet e një mijë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë pikë pesëdhjetë e dy) lekësh.
4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 2 780 000 (dy milionë e shtatëqind e tetëdhjetë mijë) lekë, do të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 63 521 159 (gjashtëdhjetë e tre milionë e pesëqind e njëzet e një mijë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekësh, të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave, pranë Bankës së Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.
6. Shpronësimi të fillojë më 15.10.2010 dhe të përfundojë më 15.1.2011.
7. Pronarët e listave që i bashkëlidhen këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP”, do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
8. Pronarët e listave që i bashkëlidhen këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP/ Detyrime ndaj të tretëve”, do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë përmbushur detyrimet ligjore dhe të kenë paraqitur dokumentacionin e pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
9. Pronarët e listave që i bashkëlidhen këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Leje ndërtimi”, do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë tekniko – ligjor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

10. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP”, në përputhje me dokumentacionin e pronësisë.

11. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve, për të cilët është bërë shënimi “Leje ndërtimi”, në bazë të dokumentacionit të plotë tekniko-ligjor.

12. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP/ Detyrime ndaj të tretëve”, pasi të kenë përmbushur detyrimet ligjore dhe të kenë paraqitur dokumentacionin e pronësisë.

13. Brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Fier, Mallakastër dhe Tepelenë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t’i vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, dhe të bëjë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

14. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme Fier, Mallakastër dhe Tepelenë të pezullojnë të gjitha transaksionet për pasuritë e shpronësuara deri në çastin që realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

15. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme Fier, zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme Mallakastër dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme Tepelenë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE

Rrethi: Mallakastër

Qarku: Fier

Komuna: Fratar

Fshati: Malas

Nr.	Pronari			ZK	Nr. Pas.	Arë			Truall			Objekte Vlera lekë	Totali lekë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri			Sip.m ²	Çmimi	Vlera lekë	Sip. m ²	Çmimi	Vlera lekë			
1	Shefit	Xhaferr	Skenderaj	2556	114/112	10	659	6590					6590	Konfirmuar nga ZRPP
2	Faslli	Hazis	Llanaj	2556	114/115	348	659	229332					229332	Konfirmuar nga ZRPP
3	Azbi	Dino	Skenderaj	2556	94/5	54	659	35586					35586	Konfirmuar nga ZRPP
4	Naile	Arshi	Saliaj	2556	94/22	1781	659	1173679					1173679	Konfirmuar nga ZRPP
5	Muharrem	Bekdash	Metaj	2556	334/1	2112	659	1391808					1391808	Konfirmuar nga ZRPP
6	Novrus	Qani	Bakaj	2556	334/5	10	659	6590					6590	Konfirmuar nga ZRPP
7	Hysnije	Muharrem	Jaupaj	2556	334/2	1085	659	715015					715015	Konfirmuar nga ZRPP
8	Pelivan	Hekuran	Jaupaj	2556	334/3	1517	659	999703					999703	Konfirmuar nga ZRPP
9	Barjame	Muhamet	Skenderaj	2556	117/3	824	659	543016					543016	Konfirmuar nga ZRPP
10	Pelivan	Rrapo	Skenderaj	2556	105/22	548	659	361132					361132	Konfirmuar nga ZRPP
11	Lefter	Hazis	Dhima	2556	124/15	1008	659	664272					664272	Konfirmuar nga ZRPP
12	Shefit	Xhaferr	Skenderaj	2556	105/11	1163	659	766417					766417	Konfirmuar nga ZRPP
13	Shefit	Xhaferr	Skenderaj	2556	108/24	1075	659	708425					708425	Konfirmuar nga ZRPP
14	Latif		Skenderaj	2556	108/23	113	659	74467					74467	Konfirmuar nga ZRPP
15	Pelivan		Skenderaj	2556	124/2				51	659	33609	259914	293523	Konfirmuar nga ZRPP
16	Bashkim		Skenderaj	2556								232332	232332	Leje ndërtimi
		TOTALI				11648		7676032	51		33609	492246	8201887	

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE

Rrethi: Tepelenë

Qarku:

Komuna: Qesarat

Fshati: Iliras

Nr.	Pronari		ZK	Nr. pas.	Arë			Truall			Kullot			Vlera totale lekë	Shënime
					Sip.m ²	Çmimi	Vlera	Sip. m ²	Çmimi	Vlera	Sip. m ²	Çmimi	Vlera		
1	Vladimir	Jaupi	1980	222/1				506	735	371910				371910	Konfirmuar nga ZRPP/detyrim ndaj te treteve
2	Bashkëpronarë		1980	228/9				21	735	15435				15435	Konfirmuar nga ZRPP
3	Bashkëpronarë		1980	228/6				16	735	11760				11760	Konfirmuar nga ZRPP
4	Bashkëpronarë		1980	228/5				16	735	11760				11760	Konfirmuar nga ZRPP
5	Agron	Kaza	1980	227/117				284	735	208740				208740	Konfirmuar nga ZRPP
6	Petrit	Lumani	1980	228/2	282	204	57528							57528	Konfirmuar nga ZRPP
7	Bashkëpronarë Veizi		1980	222/6							379	99	37521	37521	Konfirmuar nga ZRPP
8	Bashkëpronarë Veizi		1980	230/1							1450	99	143550	143550	Konfirmuar nga ZRPP
TOTALI					282		57528	843		619605	1829		181071	858204	

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE

Rrethi: Tepelenë

Qarku:

Komuna: Krahës Fshati:Lulëzim

Nr.	Pronari			ZK	Nr. Pas.	Arë			Truall			Objekt Vlera lekë	Vlera totale lekë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri			Sip.m ²	Çmimi	Vlera	Sip. m ²	Çmimi	Vlera			
1	Bashkim	Qamil	Nela	2519	99/7	233	257	59881					59881	Konfirmuar nga ZRPP
2	Sadik	Hysen	Demaj	2519	99/8	237	257	60909					60909	Konfirmuar nga ZRPP
3	Selman	Izet	Kapllani	2519	99/9	73	257	18761					18761	Konfirmuar nga ZRPP
4	Fatmir	Izet	Kapllani	2519	99/15	217	257	55769					55769	Konfirmuar nga ZRPP
5	Namik	Myslym	Hyseni	2519	99/12	109	257	28013					28013	Konfirmuar nga ZRPP
6	Razi	Izet	Kapllani	2519	99/19	216	257	55512					55512	Konfirmuar nga ZRPP
7	Rustem	Izet	Mamuti	2519	122/26	104	257	26728					26728	Konfirmuar nga ZRPP
8	Ylli	Brahim	Elmazi	2519	130/97				60	444	26640		26640	Konfirmuar nga ZRPP
9	Bardhyl		Hyseni	2519	111/30	124	257	31868					31868	Konfirmuar nga ZRPP
10	Bajram	Teme	Shehu	2519	130/78				59	444	26196	700240	726436	Konfirmuar nga ZRPP
11	Baco		Cela	2519	130/38				12	444	5328		5328	Konfirmuar nga ZRPP
12	Hysen		Ahmeti	2519	130/34				151	444	67044		67044	Konfirmuar nga ZRPP
13	Mithat	Sinan	Sina	2519	122/28	113	257	29041					29041	Proces regjistrimi
14	Axhem	Skender	Mertiri	2519	122/27	91	257	23387					23387	Proces regjistrimi
		TOTALI				1517		389869	282		125208	700240	1215317	

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE

Rrethi: Tepelenë

Qarku:

Komuna: Qesarat

Fshati: Toc

Nr.	Pronari			ZK	Nr. Pas.	Arë			Truall			Objekt Vlera lekë	Vlera totale lekë	Shënime
						Sip.m ²	Çmimi	Vlera	Sip. m ²	Çmimi	Vlera			
1	Myfyt	Xhafer	Halili	3602	12/10	1388	344	477472					477472	Konfirmuar nga ZRPP
2	Edmond	Myfit	Halili	3602	12/9	457	344	157208					157208	Konfirmuar nga ZRPP
3	Qemal	Sulo	Hasanbega	3602	68/10	1009	344	347096					347096	Konfirmuar nga ZRPP
4	Neim	Barjam	Kanani	3602	100/3	752	344	258688					258688	Konfirmuar nga ZRPP
5	Shefqet		Kanani	3602	138/15	5592	344	1923648					1923648	Konfirmuar nga ZRPP
6	Qemal		Hasanbega	3602	106/86	72	344	24768					24768	Konfirmuar nga ZRPP
7	Fatmir	Qani	Halili	3602	106/27				300	575	172500		172500	Konfirmuar nga ZRPP
8	Pellumb	Qani	Halili	3602	106/28				289	575	166175		166175	Konfirmuar nga ZRPP
9	Qemal	Sulo	Hasanbega	3602	106/88				197	575	113275		113275	Konfirmuar nga ZRPP
10	Selim	Daut	Hasani	3602	107/4	360	344	123840					123840	Konfirmuar nga ZRPP
11	Luftetar	Muharrem	Kanani	3602	100/8	687	344	236328					236328	Konfirmuar nga ZRPP
12	Vait	Jonus	Pasha	3602	86/7	26	344	8944					8944	Konfirmuar nga ZRPP
13	Hysen	Reiz	Ahmeti	3602	11/29	153	344	52632					52632	Konfirmuar nga ZRPP
14	Fadil		Cela	3602	57/3	612	344	210528					210528	Konfirmuar nga ZRPP
15	Luftar	Xhafer	Halili	3602								1854582.52	1854582.52	Leje ndërtimi
		TOTALI				11108		3821152	786		451950	1854582.52	6127684.52	

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE

Rrethi: Tepelenë

Qarku: Gjirokastrë

Qyteti: Memaliaj

Nr.	Pronari			ZK	Nr. Pas.	Arë			Truall			Objekt Vlera lekë	Vlera totale lekë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri			Sip.m ²	Çmimi	Vlera	Sip. m ²	Çmimi	Vlera			
1	Fatmir	Reshat	Llanaj	2646	2/19				112	400	44800	3309176	3353976	Konfirmuar nga ZRPP
2	Ali		Dedgjoni	2646	2/84				18	400	7200	53065	60265	Konfirmuar nga ZRPP
3	Sali		Dedgjoni	2646	2/78				243	400	97200		97200	Konfirmuar nga ZRPP/detyrime ndaj të tretëve
4	Skender	Jonuz	Beta	2646	2/68	195	235	45825					45825	Konfirmuar nga ZRPP
5	Bashkëp.Bukurie Sinani etj.			2646	3/2				25	400	10000	1378205	1388205	Konfirmuar nga ZRPP
6	Niazi		Goxharaj	2646	3/8				20	400	8000	1914499	1922499	Konfirmuar nga ZRPP
7	Bashkëp.Veli Bega etj.			2646	12/15				171	400	68400		68400	Konfirmuar nga ZRPP
8	Bashkëp.Vasil Sinani etj.			2646	8/61				128	400	51200		51200	Konfirmuar nga ZRPP
9	Asqeri	Xhemal	Vela	2646	3/3				20	400	8000		8000	Konfirmuar nga ZRPP
10	Merushe Faik Halili (Katiraj)			2646	1/32				163	400	65200		65200	Konfirmuar nga ZRPP
11	Bajram		Hoxha	2646	2/29				83	400	33200	5725351	5758551	Konfirmuar nga ZRPP
12	Reshat	Haki	Zika	2646	1/127				275	400	110000		110000	Konfirmuar nga ZRPP
13	Florika		Dedgjoni	2646	2/86	152	235	35720					35720	Konfirmuar nga ZRPP
14	Sulo		Beqiri	2646	3/9				40	400	16000		16000	Konfirmuar nga ZRPP
15	Elez		Elezi	2646	8/13							2649718	2649718	Konfirmuar nga ZRPP
16	Agim		Hasani	2646	12/18							2475463	2475463	Konfirmuar nga ZRPP
		TOTALI				347		81545	1298		519200	17505477	18106222	

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE

Rrethi: Tepelenë

Qarku: Gjirokastrë

Komuna: Krahës Fshati: Krahës i Poshtëm

Nr.	Pronari			ZK	Nr. pas.	Arë			Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri			Sip.m ²	Çmimi	Vlera leke	
1	Enver		Rama	2259	322/5	203	299	60697	Konfirmuar nga ZRPP
2	Enver		Rama	2259	318/3	278	299	83122	Konfirmuar nga ZRPP
3	Hajri		Shehu	2259	332/14	381	299	113919	Konfirmuar nga ZRPP
		TOTALI				862		257738	

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE

Rrethi: Tepelenë

Qarku:

Komuna: Fshat Memaliaj Fshati: Fshat Memaliaj

Nr.	Pronari			ZK	Nr. Pas.	Truall			Shënime
	Emri		Mbiemri			Sip.m ²	Çmimi	Vlera	
1	Beqar		Allka	2647	201/203	417	778	324426	Konfirmuar nga ZRPP
2	Leonard	Haki	Jaupi	2647	201/108	80	778	62240	Konfirmuar nga ZRPP
3	Bekim		Mece	2647	201/146	300	778	233400	Konfirmuar nga ZRPP
		TOTALI				797		620066	

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE

Rrethi: Tepelenë

Qarku: Gjirokastrë

Komuna: Fshati: Vasjar

Nr.	Pronari		ZK	Nr. Pas.	Are			Truall			Kullota			Vlera. totale lekë	Shënime
					Sip.m ²	Çmimi	Vlera	Sip. m ²	Çmimi	Vlera	Sip. m ²	Çmimi	Vlera		
1	Bashkëpronarët A.Zace		3719	,3/8							16232	114	1850448	1850448	Konfirmuar nga ZRPP
2	Bedri	Zace	3719	518/3	3891	234	910494							910494	Konfirmuar nga ZRPP
3	Luan	Canaj	3719	296/6				28	633	17724				17724	Konfirmuar nga ZRPP
4	Armo sh.a.		3719	297/39				136	633	86088				86088	Konfirmuar nga ZRPP
5	Cuman	Mataj	3719	297/50				274	633	173442				173442	Konfirmuar nga ZRPP
6	Haki	Vreka	3719	272/2				62	633	39246				39246	Konfirmuar nga ZRPP
7	Malko	Zace	3719	362/7	225	234	52650							52650	Konfirmuar nga ZRPP
8	Haseni	Muhameti	3719	362/8	334	234	78156							78156	Konfirmuar nga ZRPP
9	Lulo	Canaj	3719	243/4				221	633	139893				139893	Konfirmuar nga ZRPP
10	Xhezo	Canaj	3719	243/5				99	633	62667				62667	Konfirmuar nga ZRPP
11	Nezir	Zace	3719	297/45	697	234	163098							163098	Konfirmuar nga ZRPP
12	Përparim	Zace	3719	295/12	189	234	44226							44226	Konfirmuar nga ZRPP
	TOTALI				5336		1248624	820		519060	16232		1850448	3618132	

LISTA E SHPRONËSIMIT PËR SEGMENTIN RRUGOR LEVAN - DAMES

NR.	PRONARI			ZK	NR. pas.	TOKE ARË			KULLOTË			PYLL			VLERA TOTALE	SHËNIME
	Emri	Atësia	Mbiemri			Sip. m ²	Çmimi lekë/ m ²	Vlera lekë	Sip. m ²	Çmimi lekë/ m ²	Vlera lekë	Sip. m ²	Çmimi lekë/ m ²	Vlera lekë		
1	FSHATI FRAKULL E VOGEL ZK 1635															
1	Yzeir		Metaj	1635	115/30	375	589	220875							220875	Konfirmuar nga ZRPP
2	FSHATI GJONC ZK 1758															
2	Ismail	Qemal	Avdia	1758	.9/1	307	617	189419							189419	Konfirmuar nga ZRPP
3	Qerim	Qemal	Avdia	1758	.9/2	347	617	214099							214099	Konfirmuar nga ZRPP
4	Astrit	Muco	Saliaj	1758	.9/3	465	617	286905							286905	Konfirmuar nga ZRPP
5	Fatmir	Muco	Saliaj	1758	.9/4	231	617	142527							142527	Konfirmuar nga ZRPP
6	Ferrik	Fecorr	Myftari	1758	.9/5	268	617	165356							165356	Konfirmuar nga ZRPP
7	Kujtim	Fecorr	Myftari	1758	.9/6	221	617	136357							136357	Konfirmuar nga ZRPP
8	Lefter	Fecorr	Myftari	1758	.9/7	167	617	103039							103039	Konfirmuar nga ZRPP
3	FSHATI GORISHOVE ZK 1811															
9	Xhevdet	Hysni	Kalemaj	1811	273/9	174	479	83346							83346	Konfirmuar nga ZRPP
10	Seit	Muco	Sulkaj	1811	273/15	305	479	146095							146095	Konfirmuar nga ZRPP
11	Shefit	Agim	Begaj	1811	239/17	388	479	185852							185852	Konfirmuar nga ZRPP
4	FSHATI VRESHTAS ZK 3828															
12	Mustafa	Faik	Malaj	3828	274/14	640	481	307840							307840	Konfirmuar nga ZRPP
13	Asqeri	Faik	Malaj	3828	274/15	591	481	284271							284271	Konfirmuar nga ZRPP
5	FSHATI BUZMADH ZK 1341															
14	Ylmi	Hekuran	Bendaj	1341	223	331	450	148950							148950	Konfirmuar nga ZRPP
15	Qemal	Zenel	Musaraj	1341	278	1615	450	726750							726750	Konfirmuar nga ZRPP
16	Shpetim	Riza	Tahiraj	1341	*2146	237	450	106650							106650	Konfirmuar nga ZRPP
6	FSHATI VARIBOP ZK 3816															
17	Xhemal	Luto	Velaj	3816	42/7	4935	507	2502045							2502045	Konfirmuar nga ZRPP

